



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 170

Tiranë – E mërkurë, 30 shtator 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 95/2015 datë 17.9.2015	Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik.....	11793
Ligj nr. 96/2015 datë 17.9.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa për Qytetarët”.....	11800
Ligj nr. 97/2015 datë 17.9.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Huamarrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia e zbatimit të projektit”, dhe KfW Frankfurt am Main, “KfW”, lidhur me furnizimin me ujë të zonave rurale III, me një hua në shumën 24 000 000 euro.....	11804
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 794, datë 22.9.2015	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Tiranë-Elbasan” (shtesa).....	11815
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 795, datë 22.9.2015	Për pronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (lotet I, II).....	11819



LIGJ
Nr. 95/2015

PËR SHËRBIMET DHE PRODUKTET
BIOCIDE NË SHËNDETIN PUBLIK¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të mbrojë shëndetin publik nga organizmat e dëmshëm nëpërmjet përdorimit të sigurt të produkteve biocide.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton dhe rregullon:

- vendosjen në treg të lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara;
- prodhimin, importin dhe eksportin e lëndëve biocide, produkteve biocide dhe produkteve të trajtuara;
- organizimin dhe funksionimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, në mjediset publike dhe private, përmes produkteve biocide.

Neni 3
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për:

- përdorimet, në shëndetin publik, të produkteve biocide;
- produktet që shkatërrojnë, pengojnë apo kthejnë në të padëmshëm organizmat e dëmshëm për shëndetin, përmes rrugëve kimike ose biologjike të veprimit.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- përdorimet jobiocide të produkteve dhe lëndëve vepruese;
- produktet që shkatërrojnë, pengojnë apo kthejnë në të padëmshëm organizmat e dëmshëm për shëndetin publik, nëpërmjet rrugës fizike të veprimit dhe jo rrugëve kimike ose biologjike;
- produktet e rregulluara me akte të tjera ligjore, si: produktet e mbrojtjes së bimëve, barnat mjekësore për përdorim human, barnat mjekësore për përdorim veterinar, pajisjet mjekësore, lëndët kozmetike.

3. Parashikimet e këtij ligji nuk bien ndesh me dispozitat e legjislationit përkatës që trajton çështje që kanë lidhje me produktet biocide.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- “Produkt biocid” është:
 - çdo substancë ose përzierje që përbëhet nga, përmban ose prodhon një ose më shumë lëndë vepruese, e përgatitur në formën, në të cilën u kalon për përdorim përdoruesve, me qëllim shkatërrimin, pengimin, kthimin në të padëmshëm, parandalimin e veprimit ose ushtrimin e kontrollit mbi efektin e çdo organizmi të dëmshëm, përmes çdo rruge tjetër, përveç veprimit të thjeshtë fizik ose mekanik;
 - çdo substancë ose përzierje, që gjenerohet nga substanca ose përzierja, përdorimi primar i të cilave nuk është ai biocid, me qëllim shkatërrimin, pengimin, kthimin në të padëmshëm, parandalimin e veprimit ose ushtrimin e kontrollit mbi efektin e çdo organizmi të dëmshëm, përmes çdo rruge tjetër, përveç veprimit të thjeshtë fizik ose mekanik;
 - një produkt i trajtuar që ka si funksion primar atë biocid.

b) “Lëndë vepruese në produktet biocide” është një substancë kimike apo mikroorganizëm që ka efekt ndaj organizmave të dëmshëm.

c) “Përdorues i produkteve biocide” është çdo person që përdor produktet biocide, sipas udhëzimeve përkatëse, me qëllim shkatërrimin, pengimin apo kthimin e organizmave të dëmshëm në të padëmshëm për shëndetin, nëpërmjet rrugëve kimike ose biologjike të veprimit.

¹Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Rregulloren (BE) 528/2012 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 22 maj 2012, “Mbi bërjen të disponueshme për treg dhe përdorimin e produkteve biocide”, e ndryshuar”, Numri CELEX 32012R0528, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 167, datë 27.6.2012, faqe 1-123.



ç) “Përdorues profesionist” është një person i trajnuar dhe i certifikuar nga institucionet e licencuara për këtë qëllim, për përdorimin e produkteve biocide.

d) “Produkte biocide me rrezikshmëri të ulët” janë produkte biocide që përmbajnë një apo më shumë lëndë vepruese, të cilat, në kushtet e përdorimit, mund të shfaqin rrezik të ulët për njerëzit, kafshët dhe mjedisin.

dh) “Organizëm i dëmshëm” është çdo organizëm i gjallë, prania e të cilit është e padëshirueshme dhe shkakton efekte të dëmshme për njerëzit, (aktivitetet apo produktet që ata përdorin ose prodhojnë), për kafshët dhe mjedisin.

e) “Lëndë që paraqet shqetësim” është çdo lëndë, përveç lëndës vepruese, e cila ka vetinë të shkaktojë efekte të padëshirueshme, të menjëhershme ose të vonuara, në shëndetin e njerëzve, sidomos në grupet e ndjeshme, në shëndetin e kafshëve ose në mjedis, që është e pranishme ose formohet në një produkt biocid me përqendrim të mjaftueshëm dhe krijon efekt të dëmshëm.

ë) “Metabolitë” janë produkte që rezultojnë nga degradimi ose nga reaksione të lëndës vepruese.

f) “Mbetje” janë një apo më shumë substanca, përfshirë produktet e metabolizmit, degradimit ose reaksionit, që rezultojnë nga përdorimi i një produkti biocid dhe gjenden në ose mbi produktet me origjinë bimore ose shtazore, burimet e ujit, ujin e pijshëm, ushqimet, ushqimet e kafshëve ose mjedis.

g) “Papistëri” është çdo përbërës, i ndryshëm nga lënda vepruese e pastër, i pranishëm në lëndën vepruese të prodhuar, përfshirë edhe izomerët inaktivë, që rezultojnë nga procesi i fabrikimit ose nga degradimi gjatë ruajtjes.

gj) “Bërje e disponueshme për treg” është çdo furnizim i një produkti biocid ose i një produkti të trajtuar, i destinuar për t’u shpërndarë ose përdorur në kuadër të një aktiviteti tregtar, përkundrejt pagesës ose pa pagesë.

h) “Vendosja në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë për tregun shqiptar e një produkti biocid ose e një produkti të trajtuar.

i) “Përdorimi i produktit biocid” është tërësia e veprimeve që kryhen me një produkt biocid, përfshirë ruajtjen, manipulimin, përzierjen dhe aplikimin.

j) “Produkt i trajtuar” është çdo substancë, përzierje ose produkt që është trajtuar me një ose më shumë produkte biocide apo i përmban ato në mënyrë të qëllimshme.

k) “Autorizim” është akti administrativ, me të cilin autoriteti kompetent autorizon bërjen të disponueshme për treg dhe përdorimin e produkteve biocide, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.

l) “Mbajtës i autorizimit” është një person fizik ose juridik që është përgjegjës, në bazë të autorizimit, për vendosjen në treg të produktit biocid.

ll) “Familje e produkteve biocide” është një grup i produkteve biocide që ka të njëjtën lëndë vepruese, përbërje të ngjashme, me variacione specifike dhe nivele të ngjashme të riskut e efikasitetit, dhe përdorime të ngjashme.

m) “Autoriteti kompetent” është ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

n) “Publicitet” është çdo mënyrë apo mjet i promovimit të shitjes ose përdorimit të produkteve biocide, nëpërmjet materialeve të printuara ose elektronike dhe medie.

nj) “Mikroorganizëm” është çdo entitet mikrobiologjik, qelizor ose joqelizor, i aftë të replikojë apo transferojë materialin gjenetik, ku përfshihen kërpudhat e klasave të ulëta, viruset, bakteriet, myqet, algat, protozoaret dhe helmintet parazitike mikroskopike.

o) “Mjaftueshmërisht i efektshëm” është aftësia e produktit biocid të prodhojë efektin /efektet, sikurse përshkruhet në fletën shoqëruese të produktit, e lidhur jo vetëm me efikasitetin intrinsek të përbërjes aktive, por edhe me vetitë e përbërësve joaktivë, të përfshira në produkt, si p.sh. surfaktante, tretës, si dhe me mënyrën e përdorimit të produktit.

KREU II

PRODUKTET BIOCID

Neni 5

Klasifikimi i produkteve biocide

1. Produktet biocide klasifikohen sipas nivelit të rrezikshmërisë dhe objektit të veprimit të produktit biocid.



2. Produktet biocide, sipas rrezikshmërisë, klasifikohen në produkte biocide me rrezikshmëri të ulët dhe produkte biocide me rrezikshmëri të lartë. Klasifikimi i produkteve biocide bazohet në klasifikimin e lëndëve vepruese, lidhur me efektet kancerogjene, mutagjene, toksike për riprodhimin, efektet në mjedis dhe veti të tjera të papranueshme, që lidhen si me vetitë e lëndëve bazë, lëndëve vepruese, lëndëve vepruese teknike, ashtu edhe me vetitë e lëndëve që paraqesin shqetësim, metabolitëve, mbetjeve dhe papastërtive.

3. Klasifikimi i produkteve biocide, sipas objektit të veprimit, kryhet duke u bazuar në qëllimin fillestar të përdorimit të produktit dhe përcakton klasë në produkteve biocide.

4. Klasifikimi i produkteve biocide, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 6

Prodhimi i produkteve biocide

1. Prodhimi i produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, të licencuar, që plotësojnë kërkesat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë personat fizikë ose juridikë, për t'u licencuar për prodhimin e produkteve biocide, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Kriteret e përgjithshme të vendosjes në treg të produkteve biocide

1. Një produkt biocid mund të vendoset në treg nëse:

- a) është mjaftueshmërisht i efektshëm;
- b) nuk ka efekte të padëshirueshme në organizmat që janë objekt i kontrollit me produkte biocide, si: nivel të papranueshëm të rezistencës apo rezistencës së kryqëzuar dhe vuajtje e dhimbje të panevojshme të vertebrorët;
- c) nuk ka efekte të papranueshme në vetvete ose nëpërmjet mbetjeve, të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta, në shëndetin e njerëzve e të kafshëve, përmes ujit të pijshëm, ushqimit, ajrit të brendshëm apo pasojave në mjedisin e punës dhe në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore;

ç) nuk ka efekte të papranueshme në mjedis, në vetvete ose përmes mbetjeve, veçanërisht për sa i përket shpërndarjes në mjedis, ndotjes së ujërave sipërfaqësore të ëmbla dhe të kripura, ujërave nëntokësore dhe ujit të pijshëm, si dhe ndikimit në organizmat që nuk janë objekt i kontrollit me produkte biocide;

d) mund të përcaktohet, sipas kërkesave të miratuara, natyra dhe sasia e lëndëve vepruese në përbërje të tij, çdo papastërti dhe bashkëformulim i rëndësishëm nga pikëpamja toksikologjike apo ekotoksikologjike, si dhe mbetjet me rëndësi toksikologjike apo mjedisore, që rezultojnë nga përdorimi i autorizuar i tij;

dh) vetitë e tij fizike dhe kimike janë përcaktuar dhe vlerësuar si të pranueshme, për qëllime që lidhen me përdorimin, ruajtjen dhe transportin e duhur të produktit.

2. Respektimi i kriterëve të mësipërme është i lidhur me njohuritë ekzistuese shkencore dhe teknike, kushtet e përdorimit të produktit biocid, sipas përcaktimeve të autorizuar nga strukturat përkatëse, duke respektuar kushtet normale, në të cilat produkti biocid mund të përdoret, mënyrën si do të përdoret materiali që trajtohet me të, pasojat që rrjedhin nga përdorimi i tij dhe largimi i mbetjeve përkatëse.

3. Përdorimi i produkteve biocide nga përdorues profesionistë apo nga përdorues joprofesionistë kushtëzohet nga klasifikimi i produkteve biocide në lidhje me toksicitetin, toksicitetin për riprodhimin dhe mutagjenicitetin.

Neni 8

Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide

1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.



3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuara, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

- a) produkte biocide të prodhuara në vend;
- b) produkte biocide të autorizuara në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;
- c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuara në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Vendosja në treg e produkteve biocide

1. Produktet biocide vendosen në treg pasi janë autorizuar, sipas procedurës së parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Vendosja në treg e produkteve biocide kryhet nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, të cilët, pavarësisht nga sasia e produktit, plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë të kontraktuar një person, në pozicionin e drejtuesit teknik, të diplomuar në degët biologji, kimi, agronomi ose shëndet publik;
- b) kanë mjedise të përshtatshme për ushtrimin e aktivitetit, garantojnë kushte për sigurinë e personelit;
- c) kanë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar produkte biocide, sipas dokumentacionit të autorizimit të produktit;

ç) për rastet e tregtimit të produkteve biocide me rrezikshmëri të lartë kanë mjedise të veçanta tregtimi.

Neni 10

Ruajtja dhe transporti i produkteve biocide

1. Çdo person fizik ose juridik, që ruan apo transporton produkte biocide, duhet:

a) të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e njerëzve, kafshëve, bimëve, mjedisin dhe, në veçanti, të shmangë ndotjen e ujërave;

b) të sigurojë që çdo punëmarrës që kryen veprime të ruajtjes apo transportit të produkteve biocide të jetë trajnuar, udhëzuar dhe informuar nga punëdhënësi për zbatimin e akteve rregullatore përkatëse.

2. Ruajtja e produkteve biocide bëhet në mjedise të posaçme, të pozicionuara në mënyrë të përshtatshme, me kapacitetin e duhur, të ndërtaura me materiale zjarrduruese, me hyrje-dalje të përshtatshme, të thata e të mbrojtura nga ngrica, të ndriçuara dhe të ventiluara, të pajisura me shenja paralajmërimi, të mbrojtura nga aktet e vjedhjes apo shkatërrimit, të pajisura, të organizuara dhe të plotësuara me personel, për të përmbushur administrimin e produkteve.

3. Transporti i produkteve biocide kryhet me mjete të sigurta dhe të përshtatshme, që nuk transportojnë produkte ushqimore, ushqime për kafshët apo barna mjekësore, nuk dëmtojnë paketimet e produkteve biocide, nuk ekspozojnë ngarkesën ndaj shiut, janë lehtësisht të pastrueshme, të pajisura me mjete të mbrojtjes personale, të pajisura me pajisje të emergjencës dhe ndihmës së parë mjekësore, të pajisura me mjete kundër zjarrit.

4. Rregullat për mënyrën e paketimit, ruajtjes dhe transportit të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE TË SHËRBIMIT TË PRODUKTEVE BIOCIDE NË SHËNDETIN PUBLIK

Neni 11

Shërbimi i produkteve biocide në shëndetin publik

1. Shërbimi i produkteve biocide në shëndetin publik është shërbimi që mundëson shkatërrimin, pengimin, kthimin në të padëmshëm, paranda-



limin e veprimit apo kontrollin e efektit të çdo organizmi të dëmshëm, përmes rrugëve biologjike ose kimike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik.

2. Shërbimi i produkteve biocide në shëndetin publik realizohet nëpërmjet:

- a) strukturës së posaçme për shëndetin publik në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;
- b) Institutit të Shëndetit Publik;
- c) strukturave rajonale të shëndetit publik;
- ç) organeve të pushtetit vendor;
- d) personave fizikë ose juridikë të licencuar për përdorimin e produkteve biocide;
- dh) çdo individ që përdor, sipas udhëzimeve përkatëse, produktet biocide me rrezikshmëri të ulët.

Neni 12

Autoriteti kompetent

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë është autoriteti kompetent që harton politikat për shërbimin biocid në shëndetin publik dhe organizon e ndjek zbatimin praktik e shkencor të këtij shërbimi, nëpërmjet:

- a) inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit;
- b) sekretariatit të autorizimit të produkteve biocide;
- c) komisionit të autorizimit të produkteve biocide;
- ç) Institutit të Shëndetit Publik.

Neni 13

Sekretariati i autorizimit të produkteve biocide

1. Sekretariati i autorizimit të produkteve biocide është pjesë e strukturës dhe organikës së autoritetit kompetent.

2. Sekretariati i autorizimit të produkteve biocide kryen procedurën e autorizimit të produkteve biocide.

Neni 14

Komisioni i autorizimit të produkteve biocide

1. Komisioni i autorizimit të produkteve biocide është një organ teknik këshillimor në mbështetje të autoritetit kompetent.

2. Komisioni i autorizimit të produkteve biocide përbëhet nga specialistë të kualifikuar në fushat e mbrojtjes së mjedisit, epidemiologjisë, mikrobiologjisë, entomologjisë, toksikologjisë, mjekësisë, farmakologjisë, kimisë, biologjisë, veterinarisë, agronomisë, inxhinierisë kimike, si dhe fusha të

tjera që përcaktohen nga autoriteti kompetent rast pas rasti.

3. Komisioni i autorizimit të produkteve biocide jep rekomandime për lëshimin apo refuzimin e aktit të autorizimit dhe vendosjen në treg të produkteve biocide, ndalimin apo kufizimin e përdorimit të produkteve biocide dhe përcaktimin e formulimit kuadër të produkteve biocide.

4. Përbërja, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të komisionit të autorizimit të produkteve biocide përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

Neni 15

Instituti i Shëndetit Publik

1. Instituti i Shëndetit Publik ka për detyrë:

a) të monitorojë dëmtuesit e shëndetit publik, të përcaktojë statusin e tyre, metodat e kontrollit dhe të informojë ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) të bëjë diagnostikimin dhe prognozë-sinjalizimin e dëmtuesve në shëndetin publik, duke përcaktuar edhe masat e kontrollit të tyre;

c) të bëjë provat biologjike të efektivitetit dhe analizat fiziko-kimike të produkteve biocide, për monitorimin e tyre;

ç) të kryejë trajnimin e përdoruesve profesionistë të shërbimit të produkteve biocidenë shëndetin publik;

d) të kryejë trajnimin e personelit në institucionet e varësisë, përgjegjës për monitorimin e shërbimit të produkteve biocide në shëndetin publik;

dh) të kryejë vlerësimin e produkteve biocide gjatë dhe pas procedurës së autorizimit;

e) të kryejë hulumtime me eksperimente, analiza kimike, ekzaminime të lëndëve, në kushtet e monitorimit dhe përcaktimin e vetive të rëndësishme, ndikimeve dhe efekteve, në mënyrë që hulumtimet shkencore të jenë të ndërlydhura me zhvillimin e produkteve biocide të reja.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për arsimin profesional nxjerrin udhëzim të përbashkët për trajnimin dhe certifikimin e përdoruesve profesionistë që kryejnë shërbimin e produkteve biocide në shëndetin publik.



Neni 16

Subjektet që kryejnë shërbime të produkteve biocide në shëndetin publik

1. Instituti i Shëndetit Publik dhe strukturat rajonale të shëndetit publik, vetë ose nëpërmjet operatorëve privatë, sipas legjislacionit në fuqi për koncesionet dhe partneritetin publik-privat, kryejnë shërbime biocide në shëndetin publik, për:

a) kufizimin dhe eliminimin e vatrave epidemike;

b) ushtrimin e përgjegjësive në pikat e kalimit kufitar, nëpërmjet shërbimit sanitaro-antiepidemik;

c) kontrollin e organizmave të dëmshëm që nuk mund të kontrollohen nga subjektet private;

ç) rrethana të veçanta, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Personat fizikë dhe juridikë, të licencuar, kryejnë shërbime biocide në shëndetin publik, sipas kërkesës së çdo personi të interesuar, në zbatim të rregullave dhe normave higjieno-sanitare.

3. Organet e pushtetit vendor kryejnë shërbime biocide në shëndetin publik, brenda juridiksionit të tyre, duke u përqendruar në hapësirat dhe institucionet publike.

Neni 17

Përgjegjësitë e përdoruesve të produkteve biocide

Përdoruesit e produkteve biocide, gjatë ofrimit të shërbimeve biocide në shëndetin publik, kanë këto përgjegjësi:

a) të mos rrezikojnë jetën e tyre, jetën e të tjerëve dhe të mos shkaktojnë ndikime të dëmshme në shëndetin e njeriut, kafshëve dhe në mjedis;

b) të zbatojnë metodat apo masat e kombinuara fizike, kimike, biologjike e masa të tjera të përshtatshme për pengimin e organizmave të dëmshëm, si dhe të zbatojnë masat ligjore për mbrojtjen e shëndetit të njeriut, kafshëve dhe mjedisit, në pajtim me udhëzimet për përdorimin e produkteve biocide;

c) të përdorin produkte biocide duke respektuar vlerat kufi, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi;

ç) të respektojnë udhëzimet e paraqitura në etiketën, paketimin e produkteve biocide apo në fletën udhëzuese për përdorim;

d) në rast përdorimi të produkteve biocide nga përdoruesit profesionistë, të zbatohen rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë;

dh) të raportojnë qëllimin e përdorimit të produktit biocid dhe mënyrën e aplikimit të tij pranë autoritetit kompetent.

KREU IV

KONTROLLI I ORGANIZMAVE TË DËMSHËM NË SHËNDETTIN PUBLIK

Neni 18

Masat paraprake të kontrollit të organizmave të dëmshëm në shëndetin publik

Personat fizikë ose juridikë, prodhues apo tregtues të mallrave e ofrues shërbimesh, në varësi të rekomandimeve të inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit dhe në varësi të rrezikshmërisë së produktit biocid, janë të detyruar:

a) të kryejnë shërbimin e kontrollit të organizmave të dëmshëm në shëndetin publik;

b) të kërkojnë kryerjen e shërbimeve të caktuara të kontrollit të organizmave të dëmshëm nga subjekte të licencuara për shërbimin biocid në shëndetin publik;

c) të konsultohen me specialistë të shëndetit publik apo përdorues profesionistë për planet dhe programet për kontrollin e organizmave të dëmshëm në shëndetin publik;

ç) të dokumentojnë zbatimin e planeve apo programeve përkatëse.

Neni 19

Masat e veçanta të kontrollit të organizmave të dëmshëm në shëndetin publik

1. Në rastet e përhapjes dhe shtimit masiv të organizmave të dëmshëm në shëndetin publik, të cilët nuk mund të kufizohen me metodat e zakonshme të kontrollit, ministri përgjegjës për shëndetësinë shpall gjendjen e emergjencës shëndetësore.

2. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton masat përkatëse, në kuadër të Planit Kombëtar të Emergjencave Shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.



KREU V
KONTROLLI DHE MONITORIMI I
ZBATIMIT TË LIGJIT

Neni 20

Kontrolli dhe monitorimi

1. Kontrolli për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, në pikat e prodhimit në vend, në degët doganore, në pikat e ruajtjes dhe në pikat e vendosjes në treg, kryhet nga inspektorati që mbulon fushën e shëndetit.

2. Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit, në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ka këto përgjegjësi:

a) të inspektojë hapësirat, objektet, aparaturat, pajisjet dhe dokumentacionin e personave fizikë ose juridikë që ofrojnë shërbime të produkteve biocide në shëndetin publik;

b) të kontrollojë gjendjen fiziko-kimike të produktit biocid dhe të marrë mostra të produkteve biocide, sipas nenit 38, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

c) të verifikojë nëse produktet biocide janë të autorizuar ose jo, me përjashtim të rasteve të parashikuara në këtë ligj;

ç) të kontrollojë nëse produktet biocide janë bërë të disponueshme për treg, në përputhje me kërkesat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij;

d) të kontrollojë nëse produktet biocide të vendosura në treg janë klasifikuar, paketuar dhe etiketuar sipas kërkesave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

dh) të kontrollojë nëse subjekti është i licencuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të vendosë për asgjësimin e produktit biocid, sipas legjislacionit në fuqi, nëse konstatohet se produkti biocid është hedhur në treg i paautorizuar dhe është jashtë periudhës së përdorimit.

3. Në rastet kur produkti biocid importohet, verifikimi dhe vlerësimi i dokumenteve shoqëruese të tij në pikat e kalimit kufitar është i detyrueshëm dhe kryhet nga përfaqësuesit e inspektoratit që mbulon fushën e shëndetit dhe autoriteteve doganore, sipas kompetencave përkatëse.

4. Instituti i Shëndetit Publik është struktura përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

KREU VI
KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 21

Kundërvajtjet administrative dhe gjobat

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) shkelja e nenit 8, të këtij ligji, bërja e disponueshme për treg e produkteve biocide, pa marrë autorizimin për bërjen të disponueshme për treg, dënohet me gjobë 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe kthimin e produktit biocid në vendin e origjinës/fabrikën e prodhimit, në rastin e prodhimit në vend, me shpenzimet e personit fizik ose juridik që ka kryer shkeljen. Kthimi i produktit kryhet nga personi fizik ose juridik që kryen shkeljen, me shpenzimet e tij, në të gjitha rastet e konstatuara gjatë inspektimit në pikat doganore, nga Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit;

b) vendosja në treg e produkteve biocide pa plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 2, shkronja “a”, të nenit 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë;

c) vendosja në treg e produkteve biocide pa plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 2, shkronja “b”, të nenit 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

ç) vendosja në treg e produkteve biocide pa plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 2, shkronja “c”, të nenit 9, të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë;

d) transporti dhe ruajtja e produkteve biocide në kundërshtim me secilën nga kërkesat e parashikuara në nenin 10, të këtij ligji, dënohet me gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për produktet biocide me rrezikshmëri të ulët dhe 100 000 (njëqind mijë) lekë për ato me rrezikshmëri të lartë;

dh) shkelja e nenit 17, të këtij ligji, mosrespektimi i përgjegjësive nga përdoruesit, për produktet biocide me rrezikshmëri të lartë, dënohet me gjobë 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Në rast përsëritjeje të shkeljeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, personave fizikë ose juridikë u hiqet licenca.

3. Masa e gjobës është dënim kryesor, kur parashikohet si dënim më vete dhe dënim plotësues, kur jepet njëkohësisht me masën e kthimit të produktit në vendin e origjinës.



Neni 22

Procedurat e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes administrative

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative, siç është përcaktuar në nenin 21, të këtij ligji, e ka inspektori që mbulon fushën e shëndetit.

2. Procedurat e shqyrtimit të dhënies së masave administrative, si dhe ankimit të vendimit administrativ bëhen në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit

Ekzekutimi i vendimit kryhet sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VII

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Aktet nënljore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënljore në zbatim të neneve 5, pika 4; 6, pika 2; 8, pika 5; 10, pika 4; dhe 14, pika 4, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për shëndetësinë që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënljore në zbatim të nenit 19, pika 2, të këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë dhe ministri përgjegjës për arsimin profesional ngarkohen që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët në zbatim të nenit 15, pika 2, të këtij ligji.

Neni 25

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.9.2015

Shpallur me dekretin nr. 9232, datë 25.9.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ

Nr. 96/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EVROPA PËR QYTETARËT”

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Evropa për qytetarët”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 17.9.2015

Shpallur me dekretin nr. 9233, datë 25.9.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani



Komisioni Evropian

Bruksel, më 1.8.2014
C(2014) 5366, përfundimtar

ANEKSI 1

ANEKS I VENDIMIT TË KOMISIONIT
PËR MIRATIMIN NË EMËR TË
BASHKIMIT EVROPIAN, TË NJË
MARRËVESHJEJE MBI PJESËMARRJEN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
PROGRAMIN “EVROPA PËR
QYTETARËT”

ANEKS

MARRËVESHJEJE

NDËRMJET BASHKIMIT EVROPIAN DHE
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MBI
PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EVROPA
PËR QYTETARËT”

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si “Komisioni” në emër të Bashkimit Evropian, nga njëra anë, dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në vijim i referuar si “Shqipëria”, nga ana tjetër,

duke marrë në konsideratë se:

1. Një Marrëveshje Kuadër është nënshkruar më 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë², e cila vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Bashkimit. Neni 5 i Marrëveshjes Kuadër parashikon se afatet dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë në çdo program të veçantë, do të vendoset nga Komisioni dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë;

2. Programi “Evropa për qytetarët” është krijuar nga Rregullorja e Këshillit (BE) nr. 390/2014, e datës 14 prill 2014;³

3. Subjektet e themeluara në Shqipëri duhet të kenë të drejtën të marrin pjesë në aktivitetet e vazhdueshme, të cilat duhet të fillojnë para hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Si pasojë, kostot e kryera për këto aktivitete, zbatimimi i të cilave fillon më 2014-n, mund të konsiderohen të pranueshme sipas të njëjtave kushteve si ato që

aplikohen për kostot e kryera nga subjekte të themeluara në Shtetet Anëtare, me kusht që kjo Marrëveshje hyn në fuqi para përfundimit të veprimit në fjalë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Programi

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin “Evropa për qytetarët” (në vijim i referuar si “Programi”), në përputhje me kushtet e parashtruara në Marrëveshjen Kuadër, të datës 22 nëntor 2004, ndërmjet Komunitetit Evropian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit, dhe sipas afateve dhe kushteve të përmendura në nenet 2–5 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Afatet dhe kushtet e pjesëmarrjes në Program

Pjesëmarrja e Shqipërisë në aktivitetet e Programit duhet të jetë në përputhje me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuar në Rregulloren e Këshillit (BE) nr. 390/2014.

Afatet dhe kushtet e zbatueshme për dorëzimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e aplikimeve dhe për zbatimin e veprimeve nga subjekte të pranueshme nga Shqipëria duhet të jenë të njëjta ai ato që janë zbatuar për subjektet e pranueshme nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian.

Shqipëria duhet të vendosë strukturat dhe mekanizmat e duhur në nivel kombëtar dhe duhet të miratojë të gjitha masat e tjera të nevojshme për koordinimin kombëtar dhe organizimin e aktiviteteve, për të zbatuar Programin në përputhje me dispozitat përkatëse në rregulloren që krijon këtë Program. Në veçanti, Shqipëria merr përsipër të krijojë një Pikë Kontakti “Evropa për qytetarët”, në përputhje me udhëzimin e parashikuar nga Komisioni.

Për të marrë pjesë në Program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut financiar për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 3 më poshtë.

² OJL 192, 22.7.2005, f. 2

³ OJL 115, 17.4.2014, f. 3



Kontributi financiar i Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj dhe zbatimin e Programit do t'i shtohet shumë së rezervuar çdo vit në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për ndarje buxhetore për të përmbushur detyrimet financiare që rrjedhin nga forma të ndryshme masash të nevojshme për zbatimin, menaxhimin dhe funksionimin e Programit.

Një nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian do të përdoret për procedurat që lidhen me kërkesat, kontratat dhe raportet, si edhe për aspekte të tjera administrative të Programit.

Neni 3

Kontributi financiar

Rregullat që drejtojnë kontributin financiar të Shqipërisë janë përcaktuar në aneksin I.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Auditëve, në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e Programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme mbi një bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë. Shqipëria do t'i paraqesë Komisionit raportet përkatëse dhe do të marrë pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga Bashkimi Evropian në atë kontekst.

Rregullat që lidhen me kontrollin financiar, rivendosjen dhe masat e tjera kundër mashtrimit janë parashtruar në aneksin II.

Neni 5

Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për kohëzgjatjen e Programit. Megjithatë, nëse Bashkimi Evropian do të vendosë të shtyjë afatin pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda Programit, afati i kësaj Marrëveshjeje do të zgjatet në mënyrë automatike nëse asnjë palë nuk e denoncon atë brenda një muaji pas hyrjes në fuqi të një akti ligjor, i cili zgjat Programin.

Bashkimi Evropian dhe Shqipëria mund t'i përfundojnë aktivitetet sipas kësaj Marrëveshjeje në çdo kohë pas njoftimit me shkrim dymbëdhjetë muaj para. Projektet dhe aktivitetet në progres në kohën e përfundimit do të

vazhdojnë deri në plotësimin e tyre sipas kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, si edhe marrëveshjeve kontraktuale që zbatohen për këto projektet dhe aktivitete dhe dispozitat e anekseve.

Aneksat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të palëve.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit me shkrim me anë të të cilit Shqipëria njofton Komisionin nëpërmjet kanaleve diplomatike mbi përmbushjen e kërkesave ligjore të brendshme për hyrjen e saj në fuqi.

Hartuar në, datë.....

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Erion Veliaj

Ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë i Republikës së Shqipërisë

Hartuar në, datë.....

Për Komisionin, në emër të Bashkimit Evropian

Gregory Paulger

Drejtor i Përgjithshëm

Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimeve

ANEKSI I

RREGULLAT QË DREJTOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EVROPA PËR QYTETARËT”

Kontributi financiar vjetor që duhet të paguhet nga Shqipëria në Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian për të marrë pjesë në Programin “Evropa për qytetarët” do të jetë 20 000 euro.

Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e jetesës që kryhen nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimet e pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e Komitetit të përmendur në nenin 9 të Rregullores së Këshillit (BE) nr. 390/2014 ose mbledhje të tjera në lidhje me zbatimin e Programit duhet të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në përputhje me procedurat aktualisht në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.



Shuma maksimale e mbështetjes financiare që do të ndahet nga Programi për aktivitetet e Pikës së Kontaktit “Evropa për qytetarët” do të jetë 10 000 euro.

Rregullorja (BE, Euratom) nr. 966/2012, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 25 tetor 2012, mbi rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Evropian, do të zbatohet për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

Kur kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi dhe në fillim të çdo viti buxhetor pasues, Komisioni do t’i dërgojë Shqipërisë një ftesë për fonde që korrespondon me kontributin e saj të shpenzimeve që mbulohen nga kjo Marrëveshje.

Ky kontribut paguhet në euro në një llogari bankare të Komisionit të shprehur në euro.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj për shpenzimet vjetore, jo më vonë se tre muaj pas datës së ftesës, me kusht që ftesa për fondet të dërgohet nga Komisioni para datës 1 mars ose maksimumi një muaj pas ftesës për fonde nëse dërgohet më vonë. Çdo vonesë në pagesën e kontributit do të shkaktojë pagesën e interesit të munguar nga Shqipëria për shumën e papaguar nga data e duhur. Norma e interesit do të jetë norma e zbatuar nga Banka Qendrore Evropiane për operacionet e saj kryesore të rifinancimit, siç publikohet në serinë “C” të Fletores Zyrtare të Bashkimit Evropian, në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajve në të cilët bie afati, rritur me 3.5 pikë për qind. Nëse vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që mund të rrezikojë seriozisht zbatimin dhe menaxhimin e Programit dhe në mungesë të pagesës 20 ditë pune pas dërgimit të letrës formale të kujtesës nga Komisioni për Shqipërinë, pjesëmarrja e Shqipërisë në Program për vitin përkatës do të pezullohet.

ANEKSI II

KONTROLLI FINANCIAR, RIMËKËMBJA DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollat dhe masat kundër mashtrimit nga Bashkimi

1. Në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian, si dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Marrëveshje, kontratat dhe marrëveshjet e grantit, të lidhura me kontraktorët

dhe përfituesit e Programit, themeluar në Shqipëri, parashikojnë auditime financiare dhe të tjera që kryhen në çdo kohë gjatë zbatimit të kontratës ose marrëveshjes së grantit dhe për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar nga data e pagesës së bilancit, me përjashtim për grantet e një shume të barabartë ose më të vogël se 60 000 euro, për të cilat kjo periudhë do të kufizohet në 3 vjet. Auditimet financiare, apo të tjera, do të kryhen në ambientet e kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre dhe në ambientet e përfituesve dhe kontraktuesve dhe nënkontraktuesve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni do të kenë akses të duhur në faqet, punimet dhe dokumentet dhe në të gjithë informacionin e kërkuar, në mënyrë që të kryejnë auditime të tilla, duke përfshirë edhe në formë elektronike. Kjo e drejtë aksesit do të parashikohet shprehimisht në kontratat dhe marrëveshjet e granteve, të lidhura për të zbatuar dokumentet ligjore të përmendura në këtë Marrëveshje. Gjykata Evropiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Komisioni/OLAF-i (Zyra Evropiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrolle dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat procedurale të Rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr. 2185/96, të 11 nëntorit 1996.⁴

Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të Shqipërisë, të caktuara nga autoritetet e Shqipërisë, të cilat do të njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontroleve dhe inspektimeve, në mënyrë që të mund të ofrojnë të gjithë ndihmën e nevojshme.

Nëse autoritetet e Shqipërisë në fjalë dëshirojnë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen bashkërisht me ato autoritete.

Kur pjesëmarrësit në Program i rezistojnë një kontrolli ose inspektimi në vend, autoritetet e Shqipërisë, duke vepruar në pajtim me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit /OLAF-it atë ndihmë që ata kanë nevojë për t’i

⁴ OJ L 292, 15.11.1996, f. 2



lejuar të kryejnë detyrat e tyre në kryerjen e një kontrolli ose inspektimi në vend.

Komisioni/OLAF-i raporton sa më shpejt të jetë e mundur tek autoritetet e Shqipërisë çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që ka hasur gjatë kryerjes së kontrollit ose inspektimit në terren. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it do t'i kërkohej të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Për qëllimet e zbatimit të duhur të këtij aneksi, autoritetet kompetente të Shqipërisë dhe autoritetet e Bashkimit Evropian do të shkëmbejnë rregullisht informacion dhe do të zhvillojnë konsultime me kërkesë të njëres prej palëve.

2. Autoritetet kompetente të Shqipërisë do të informojnë Komisionin, pa vonesë, mbi çdo fakt ose dyshim, i cili është njoftuar në lidhje me një parregullsi, për sa i përket lidhjes me përfundimin dhe zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve të granteve, të lidhura në zbatim të dokumenteve ligjore të përmendura në këtë Marrëveshje.

III. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për Buxhetin e Përgjithshëm të Bashkimit Evropian.

IV. Rivendosja

Vendimet e marra nga Komisioni, brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, e cila vendos një detyrim financiar mbi personat e ndryshëm nga shtetet do të jenë të ekzekutueshme në Shqipëri. Ekzekutimi do të drejtohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi, në shtetin në territorin e të cilit është kryer. Urdhri i ekzekutimit i bashkëlidhet vendimit, pa formalitet tjetër, përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar, i cili caktohet nga qeveria e Shqipërisë për këtë qëllim dhe do ta bëjë të njohur për Komisionin. Kur këto formalitete kanë përfunduar me kërkesën nga Komisioni, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në pajtim me ligjin kombëtar, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt para autoritetit kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit do t'i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Gjykimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në bazë të një klauzole arbitrazhi në një kontratë dhe një marrëveshje

granti në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të jenë të zbatueshme në të njëjtat kushte.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni do të komunikojë drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në Programin “Evropa për qytetarët”, të themeluar në Shqipëri. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjithë informacionin përkatës dhe dokumentacionin të cilin janë të detyruar të paraqesin në bazë të dokumenteve të përmendura në këtë Marrëveshje, si dhe kontratave dhe marrëveshjeve të grantit të lidhura për zbatimin e tyre.

LIGJ

Nr. 97/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
SË HUAS DHE PROJEKTIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
“HUAMARRËSI”, TË PËRFAQËSUAR
NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E
FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM,
“AGJENCIA E ZBATIMIT TË
PROJEKTIT”, DHE KfW FRANKFURT
AM MAIN, “KfW”, LIDHUR ME
FURNIZIMIN ME UJË TË ZONAVE
RURALE III, ME NJË HUA NË
SHUMËN 24 000 000 EURO**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Huamarrësi”, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar për Zhvillim, “Agjencia e zbatimit të projektit”, dhe KfW Frankfurt am Main, “KfW”, lidhur me Furnizimin me Ujë të Zonave Rurale III, me një hua në shumën 24 000 000 euro.



Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 17.9.2015

Shpallur me dekretin nr. 9234, datë 25.9.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE HUAJE DHE PROJEKTI

NDËRMJET DHE KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË (HUAMARRËSI), TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCAVE DHE FONDIT SHQIPTAR
PËR ZHVILLIM (FSHZH) (AGJENCIA E
ZBATIMIT TË PROJEKTIT) DHE KfW,
FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR
SHUMËN 24,000,000.00 EURO
UJËSJELLËSI RURAL III
(NR. 2011 66 370)

PREAMBULË

Baza për këtë Marrëveshje është marrëveshja e datës _____, ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (FC) (Marrëveshja Qeveritare).

Huamarrësi, Pala për Zbatimin e Projektit dhe KfW-ja (bashkërisht të referuara si “Palët”) kanë lidhur një Marrëveshje Financimi dhe Projekti në lidhje me Projektin e datës _____ (Marrëveshja e Projektit dhe e Financimit).

KfW-ja do të rifinancojë Huan e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me subvencione interesi nga fonde buxheti me interes të ulët të dhëna nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që përmbushin kriteret e pranimit të politikave të zhvillimit. Termat dhe kushtet e Huas pajtohen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohjen si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Mbi këtë bazë dhe me kushtin që Republika Federale e Gjermanisë ofron një garanci për Huan, KfW-ja do të japë një Hua në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti.

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua që nuk kalon një shumë totale prej 24,000,000.00 euro (Huaja).

1.2 Qëllimi. Huamarrësi do të kanalizojë Huan plotësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë Huan ekskluzivisht për rehabilitimin, rindërtimin ose ndërtimin e sistemeve të ujësjellësve ruralë dhe, nëse është e zbatueshme, për masa plotësuese të ujërave të zeza në raste emergjencash (Projekti). Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Projektit, si dhe furnizimet, mallrat, punimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga Huaja nga një marrëveshje e veçantë (Marrëveshja e Veçantë).

1.3 Taksat, detyrimet, tatimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si dhe tatimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huas

2.1 Huamarrësi e kanalizon Huan tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një grant të pashlyshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të vërtetuar në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së financimit të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Huas nuk përbën detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesat për disbursim. Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin sipas nenit 3.3, KfW-ja do të disbursojë Huan në pajtim me progresin e Projektit dhe me kërkesën e Agjencisë së Zbatimit të Projektit. KfW-ja do të kryejë disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtë muaj në përputhje me grafikun e disbursimit të parashikuar në aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projekti. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Projektit kërkon disbursime për shumat më të vogla brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në



ndonjë prej periudhave gjashtëmujore pasuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime në një shumë më të vogël se 500,000.00 euro.

3.2 Afati për kërkimin e disbursimeve. KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30.6.2019.

3.3 Kushtet paraprake të Disbursimit. KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi do të ketë demonstruar në një formë të pranueshme për KfW-në, me anë të paraqitjes së një opinionit ligjor, përmbajtja e të cilit është kryesisht në përputhje me modelin në aneksin 2, si dhe paraqitjes së kopjeve të vërtetuara (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të të gjitha dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor se Marrëveshja e Huas dhe e Projektit është ligjërish efektive dhe e zbatueshme dhe në veçanti, se:

i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave ligjore të tjera të zbatueshme për përmbushjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii) KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi dhe të gjitha detyrimet, komisionet dhe kostot e ngjashme në Republikën e Shqipërisë për dhënien e Huas;

b) palët zotërojnë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje, të nënshkruar me fuqi ligjërish detyruese;

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në nenin 12.1 janë marrë nga KfW-ja;

d) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 është në fuqi dhe efekt pa kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar Tarifën e Menaxhimit të përcaktuar në nenin 4.2;

f) nuk ka ndodhur asnjë arsye për zgjidhjen e Marrëveshjes, as ndonjë incident që do të përbente shkak për zgjidhjen e Marrëveshjes me anë të njoftimit ose skadimit ose konstatimit apo plotësimit të një kushti (arsye e mundshme për zgjidhjen e Marrëveshjes); dhe

g) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin,

operimin ose qëllimin e Projektit ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

Para disbursimit nga Huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë dokumente dhe prova të tjera që i çmon të nevojshme sipas diskrecionit të saj për të konstatuar kushtet paraprake për disbursimin të përcaktuara në këtë seksion (për shembull, në rastet e ndryshimeve të kuadrit ligjor të Huamarrësit).

3.4 Detaje të procedurës së disbursimit. Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë detajet e procedurës së disbursimit nga Marrëveshja e Veçantë dhe në veçanti, të dhëna që duhet të jepen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit të cilat dokumentojnë se shumatat e Huas së kërkuar përdoren për qëllimin e rënë dakord.

3.5 E drejta për anulimin e disbursimit. Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tij sipas nenit 10, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas me pëlqimin e ndërsjellë të të gjitha Palëve të kësaj Marrëveshjeje kundrejt pagesës së Kompensimit të Mospranimit në pajtim me dhe siç përcaktohet në nenin 3.6.

3.6 Kompensimi i mospranimit. Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume të Huas sipas nenit 3.5 ose nëse shuma e kësaj Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.2 për arsye të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të bëhet përgjegjëse, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, sipas kërkesës së saj, shumën që është e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së anuluar të Huas (Kompensimi i Mospranimit). KfW-ja do të llogaritë shumën e Kompensimit të Mospranimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e Angazhimit. Huamarrësi do të paguajë një tarifë të pakthyeshme angazhimi prej 0.25% në vit (Tarifa e Angazhimit) për shumatat e padisbursuara të Huas.

Tarifa e Angazhimit është e kërkueshme për pagesën gjashtëmujore në shumata të prapambetura në datën 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për herë të parë në datën _____, por jo më parë se në datën përkatëse pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 13.11. Tarifa e Angazhimit do të faturohet,



nëse është e zbatueshme, me efekt prapaveprues për periudhën që fillon tre muaj pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të zgjasë deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të plotë të disbursimeve nga Huaja.

4.2 Tarifa e Menaxhimit. Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njëjshme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1% të shumës së Huas të përcaktuar në nenin 1.1 (Tarifa e Menaxhimit).

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në rastin më të hershëm të të dyja datave të mëposhtme: i) para disbursimit të parë; ose ii) pas kalimit të tre muajve që prej nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja ose me kalimin e një periudhe njëmuajore pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt (në varësi se cila nga datat e përcaktuara sipas pikës “ii” është më e vonshme). Tarifa e Menaxhimit është e kërkueshme për pagesë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht ose vetëm pjesërisht ose nëse nuk është disbursuar.

5. Interesi

Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së si më poshtë:

5.1 Interesi (norma Fikse e Interesit e caktuar mbi dhënie e Huas). Huamarrësi do të paguajë normë interesi mbi Huan në një normë prej ____ në vit (siç llogaritet një Ditë Bankare pas njoftimit për KfW-në, se Marrëveshja është ratifikuar (Normë Fikse Interesi) deri në marrjen e kështit të fundit të shlyerjes sipas Grafikut të Shlyerjes sipas përcaktimit në nenin 6.1.

5.2 Llogaritja e interesit. Interesi për një shumë të disbursuar të Huas do të faturohet nga data (duke e përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga llogaria e Huas që mbahet te KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3. Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 7.1.

5.3 Datat e Pagesës. Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesë në datat e përcaktuara më poshtë (secila e referuar si “Datë Pagesë”):

a) para datës së kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë, më 30 qershor dhe 30 dhjetor

të çdo viti, për herë të parë në datën _____, por jo më parë se në Datën e Pagesës pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 13.11;

b) në datën e kërkueshme të kështit të shlyerjes së parë në bazë të nenit 6.1 së bashku me këtë kësht; dhe

c) më pas, në datat e kërkueshme të kësteve të shlyerjes në bazë të nenit 6.1.

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi do të shlyejë Huan si më poshtë:

Kësti	Data e kërkueshme	Kësti i shlyerjes	
1	30.6.2018	1,000,000.00	euro
2	30.12.2018	1,000,000.00	euro
3	30.6.2019	1,000,000.00	euro
4	30.12.2019	1,000,000.00	euro
5	30.6.2020	1,000,000.00	euro
6	30.12.2020	1,000,000.00	euro
7	30.6.2021	1,000,000.00	euro
8	30.12.2021	1,000,000.00	euro
9	30.6.2022	1,000,000.00	euro
10	30.12.2022	1,000,000.00	euro
11	30.6.2023	1,000,000.00	euro
12	30.12.2023	1,000,000.00	euro
13	30.6.2024	1,000,000.00	euro
14	30.12.2024	1,000,000.00	euro
15	30.6.2025	1,000,000.00	euro
16	30.12.2025	1,000,000.00	euro
17	30.6.2026	1,000,000.00	euro
18	30.12.2026	1,000,000.00	euro
19	30.6.2027	1,000,000.00	euro
20	30.12.2027	1,000,000.00	euro
21	30.6.2028	1,000,000.00	euro
22	30.12.2028	1,000,000.00	euro
23	30.6.2029	1,000,000.00	euro
24	30.12.2029	1,000,000.00	euro

6.2 Shumat e padisbursuara të Huas. Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të fundit të shlyerjes në pajtim me grafikun e shlyerjes të përcaktuar në nenin 6.1, përveç kur KfW-ja, sipas diskrecionit të saj, zgjedh një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta.

6.3 Shlyerjet në rast të disbursimit të paplotë. Nëse një kësht shlyerjeje është i kërkueshëm para disbursimit të plotë të Huas, kjo nuk do të cenojë grafikun e shlyerjes, në bazë të nenit 6.1, për sa kohë që kështi i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shuma e Huas e disbursuar dhe ende i pashlyer (Shuma e Papaguar e Huas). Nëse kështi i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me nenin 6.1 tejkalon Shumën e Papaguar të Huas,



ky këst shlyerjeje do të ulet në nivelin e Shumës së Papaguar të Huas dhe diferenca do të shpërndahet në mënyrë të barabartë për këstet e shlyerjes ende të papaguara. Në llogaritjen e Shumës së Papaguar të Huas, KfW-ja rezervon të drejtën për të shqyrtuar disbursimet nga Huaja që kryhen brenda një periudhe prej 45 ditësh ose disa ditë para një Date Pagese për përcaktimin e Shumës së Papaguar të Huas, vetëm për Datën e ardhshme pasuese të Pagesës.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë zbatohen për parapagimet:

a) E drejta për parapagim. Huamarrësi, në pajtim me paragrafët e mëposhtëm 6.4/b deri 6.4/e, ka të drejtë të shlyejë shuma Huaje para datës së kërkueshme të planifikuar nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 6.1;

b) Njoftimi. Një parapagim i një shume Huaje në pajtim me nenin 6.4/a i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së, jo më vonë se Dita Bankare e pesëmbëdhjetë (sipas përcaktimit në nenin 13.1) para datës së synuar të parapagimit. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të përcaktojë datën dhe shumën e parapagimit dhe detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e deklaruar;

c) Kompensimi i parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një Shumë Huaje me Normë Fikse Interesi, Huamarrësi, do t'i paguajë menjëherë KfW-së, me kërkesë, shumën që është e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja, si rezultat i këtij parapagimi. KfW-ja do të përcaktojë shumën e Kompensimit të Parapagimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një të dhënë të shumës së tarifës së parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm për shlyerjen në bazë të nenit 6.4/b;

d) Shumat e kërkueshme. Së bashku me parapagimin në pajtim me nenin 6.4/a, Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i) çdo Kompensim Parapagimi të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në pajtim me nenin 6.4/c; dhe

ii) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e papaguar të Huas dhe çdo pagesë tjetër ende të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje që është shtuar deri në datën e parapagimit;

e) Kompensimi. Neni 6.2 zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

6.5 Grafiku i rishikuar i shlyerjeve. Në rastin kur zbatohet neni 6.3 ose neni 6.4, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që do të bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, Tarifa e Angazhimit, kamatëvonesa në pajtim me nenin 7.5, kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 7.6, Kompensimi i Mospranimet dhe Kompensimi i Parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë, me muaj me tridhjetë ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që duhet të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është Ditë Bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në Ditën Bankare pasuese. Nëse Dita pasuese Bankare bie në muajin e ardhshëm kalendarik, kjo pagesë duhet të kryhet në Ditën e fundit Bankare të muajit kalendarik aktual.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi do të lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje, nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse do t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika e Gjermanisë, numër IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01 që përcakton datën e kërkueshme si një referencë shtesë (Ref. VVVVMMDD)

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk bihet dakord reciprokisht nga KfW-ja dhe Huamarrësi.

7.5 Kamatëvonesa. Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagim në pajtim me nenin 6.4 nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të caktojë kamatëvonesë në normën prej 200 pikësh bazë mbi normën e interesit në vit të përcaktuar në nenin 5.1 për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të



cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3. Kjo kamatëvonesë duhet të paguhet menjëherë me kërkesën fillestare të KfW-së.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të kësteve të shlyerjeve dhe të parapagimeve të përmendura në nenin 7.5), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim në shumë të plotë me një normë prej 200 pikësh bazë në vit mbi Normën Fikse të Interesit në bazë të nenit 5.1. Kompensimi në shumë të plotë duhet të paguhet menjëherë pas kërkesës fillestare të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të provojë që nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet kanë qenë në shumën më të vogël sesa kompensimi në shumë të plotë.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit ose marrëveshjeve të tjera të Huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Për shmangien e dyshimit, kjo do të zbatohet, veçanërisht në rastin e një mospagimi apo mospagimi të mundshëm nga Huamarrësi.

7.8 Llogaritë e bëra nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave të kërkueshme në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projekti përbëjnë të dhëna provuese *prima facie* (*Anscheinsbeweis*).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të marrë garanci nga Republika Federale e Gjermanisë për pretendimet e pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje para disbursimit të parë.

9. Kostot dhe detyrimet publike

9.1 Ndalimi i zbritjeve ose i mbajtjeve. Huamarrësi kryen të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin kur Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për arsye të tjera të bëjë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, pagesat e kryera nga Huamarrësi do të rriten në atë shumë që është e nevojshme për KfW-në, në mënyrë që të marrë të plota shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, pas zbritjes së taksave dhe detyrimeve.

9.2 Kostot. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me

disbursimin dhe shlyerjen e Huas, veçanërisht kostot e dërgimit dhe transferimit (duke përfshirë tarifatat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Taksat dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do t'i transferojë ato pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3 ose në ndonjë llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

10. Detyrime të veçanta

10.1 Detyrimet e lidhura me Projektin e Agjencisë për Zbatimin e Projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të përgatitë, do të zbatojë, do të operojë dhe do të administrojë Projektin në pajtim me praktikatat e qëndrueshme financiare dhe teknike dhe kryesisht në pajtim me konceptimin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do t'ia caktojë përgatitjen, projektimin dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të kualifikuar, të pavarur dhe zbatimin e Projektit për firma të kualifikuara;

c) do të japë kontrata për mallra, punime dhe shërbime të përmendura në nenin 10.1/b që duhet të financohen nga Huaja pas ofertimit publik konkurrues ndërkombëtar;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe të regjistrave që tregojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

e) do t'i japë mundësinë, në çdo kohë, KfW-së dhe agjentëve të saj që të inspektojnë ata libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me zbatimin dhe operimin e Projektit, si dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet e lidhura me të;

f) do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna të tjera të tilla në lidhje me Projektin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë; dhe

g) menjëherë dhe me iniciativë të vet do t'i



paraqesë KfW-së çdo pyetje të marrë nga Huamarrësi nga OECD-ja ose anëtarët e tij, sipas të ashtuquajturës “Marrëveshje për Transparençën e Kredive ODA të Bashkuara” pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në.

10.2 Detaje të zbatimit të Projektit. Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 10.1 me Marrëveshje të Veçantë.

10.3 Detyrimet e Përbashkëta të Lidhura me Projektin. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të garantojnë financimin e plotë të Projektit dhe do t'i japin KfW-së, sipas kërkesës, të dhëna që provojnë se kostot e paguara nga kjo Hua janë mbuluar; dhe

b) menjëherë dhe me iniciativën e tyre do të njoftojnë KfW-në në lidhje me të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit.

10.4 Detyrimet e Huamarrësit të lidhura me Projektin. Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike për zbatimin e Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, do t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

10.5 Pajtueshmëria. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit do të garantojnë që personat e ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, dhënien e kontratës për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen dhe kërkimin e shumave të Huas, nuk kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë apo pranojnë premtimin e pagesave të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

10.6 Transporti i furnizimeve/mallrave. Dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen Qeveritare që janë të njohura për Huamarrësin dhe Agjencinë e Zbatimit të Projektit do të zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga Huaja.

10.7 Klasifikimi *pari passu*. Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen dhe do të

përdoren të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruar dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të garantojë në masën e lejuar me ligj që ky klasifikon të garantohet edhe për të gjitha detyrimet e ardhshme të pasiguruar dhe jo të varura.

10.8 Detyrimet. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të krijojnë ose lejojnë vazhdimin e ndonjë detyrimi mbi sendet pasurore të Projektit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Një detyrim konsiderohet të jetë një e drejtë reale përdorimi, realizimi ose e drejtë tjetër për të siguruar llogaritë e arkëtueshme ose të drejta të ngjashme kolaterali.

10.9 Shitja e sendeve pasurore

Pa pëlqimin paraprak të KfW-së, as Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të shesin ndonjë send pasuror të Projektit.

11. Zgjidhja e Marrëveshjes

11.1 Arsyet për Zgjidhjen e Marrëveshjes. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 11.2 (pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes) nëse lind një rrethanë që përbën shkak të rëndësishëm (*wichtiger Grund*). Këto përfshijnë, në veçanti, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet e pagesës ndaj KfW-së kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje; Marrëveshjeje të Veçantë ose sipas Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit, si dhe ndonjë marrëveshjeje tjetër ligjërisht detyruese ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit, janë shkelur;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose nuk mund të jetë më e zbatueshme ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit;

d) ndonjë deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja thelbësore për dhënien dhe mbajtjen e Huas, rezulton e rreme, çorientuese ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

f) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se shumata e Huas janë përdorur për qëllimin e caktuar; ose

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj



kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon bisedimet me një ose më shumë prej kreditorëve të Huamarrësit mbi një moratorium, heqje dorë nga borxhet e papaguara, shtyrje të pagesave ose ndërprerje të shërbimit të borxhit.

11.2 Pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes. Nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në nenin 11.1, KfW-ja mund të pezullojë menjëherë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 11.1/a) ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuar në nenin 11.1, brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që gjithsesi duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, me pasojën që detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje pushojnë dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të plotë ose të pjesshme të Shumës së Papaguar të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumatat e tjera të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Nenet 7.5 dhe 7.6 zbatohen *mutatis mutandis* për shumatat e përshpejtuara.

11.3 Kompensimi për dëmet. Nëse kjo Marrëveshje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë Kompensimin e Mospranimit në pajtim me klauzolën 3.6 dhe/ose Kompensimin e Parapagimit në pajtim me klauzolën 6.4/c.

12. Përfaqësimi dhe deklarimet

12.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe personat që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori Ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me anë të modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë nëse revokimi i saj i shprehur nga përfaqësuesi i Huamarrësit të autorizuar në atë kohë, nuk është marrë nga KfW-ja.

12.2 Adresat. Deklarimet ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen si kopje origjinale ose, me përjashtim të kërkesave për disbursime,

me faks. Të gjitha njoftimet ose deklarimet e tjera të bëra në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am
Main/Germany
Germany
Faks: +49 69 7431-2944

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e
Kombit”
Tirana
Albania
Faks : 00355 42 22 8494

Për Agjencinë e Fondi Shqiptar për Zhvillim
Zbatimit të Rr. “Sami Frashëri”, nr. 10
Projektit: Tirana
Albania
Faks: 00355 42 2234885

12.3 Amendimet. Çdo amendim ose ndryshim i kësaj Marrëveshjeje duhet të bëhet me shkrim dhe të bihet dakord sipas rregullave nga të gjitha palët. Ministri i Financave autorizohet të nënshkruajë çdo amendim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave. Amendimet e kësaj Marrëveshjeje, që cenojnë vetëm periudhën e disponibilitetit, nuk kërkojnë aprovim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

13. Dispozita të përgjithshme

13.1 Dita bankare. Nëse i referohet kësaj Marrëveshjeje në lidhje me një “Ditë Bankare”, kjo do të thotë një ditë të ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

13.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes për të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë.

13.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose nëse ekziston një boshllëk në ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Palët e kësaj Marrëveshjeje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të



vlefshme ligjërisht që është sa më afër frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të plotësojnë çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që është sa më afër frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

13.4 Forma me shkrim. Ndryshimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje duhet të bëhen me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kjo kërkesë me shkrim vetëm me anë të formës me shkrim.

13.5 Transferimi. As Huamarrësi, as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të delegojnë ose transferojnë, rëndojnë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje Huaje dhe Projektit.

13.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji gjerman.

13.7 Periudha e kufizimit/parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje skadojnë pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilën ky pretendim ka lindur dhe kur KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni të tyre pa neglizhencë flagrante.

13.8 Heqja dorë nga imuniteti. Nëse dhe në masën që Huamarrësi aktualisht ose në të ardhmen në çdo juridiksion pretendon për vete ose sendet e tij pasurore imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestroja ose një proces tjetër ligjore dhe në masën që në një juridiksion i jep imunitet Huamarrësit ose sendeve të tij pasurore, Huamarrësi bie dakord në mënyrë të parevokueshme që të heqë dorë nga ky imunitet ndaj padive dhe në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projektit në masën më të plotë të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

Huamarrësi nuk heq dorë nga ndonjë imunitet, në lidhje me:

i) “ambientet e misionit” të tashme ose të ardhshme të përcaktuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në vitin 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhshme të përcaktuara në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) ndonjë pasuri të paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e nenit 3, paragrafët 1–3 të ligjit shqiptar nr. 8743, të datës 22.2.2001, “Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore”;

iii) ndonjë fond monetar dhe/ose shumë që

është bërë e kërkueshme dhe është paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas së drejtës publike, traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara prej saj.

13.9 Mosmarrëveshjet ligjore. Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje dhe Projektit do të zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, zbatohen sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit do të përbëhet nga një ose tre arbitra që do të emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) të zbatueshme herë pas here;

b) Gjykimi në arbitrazh do të kryhet në Frankfurt am Main. Gjuha e procedimit do të jetë anglishtja.

13.10 Transmetimi i informacionit. KfW-ja ka të drejtë t'i transmetojë lëshuesit të garancisë federale të përmendur në nenin 8, Republikës Federale të Gjermanisë, Gjykatës Federale të Auditëve, anëtarëve të KfW Bankengruppe dhe palëve të tjera të treta të lidhura ligjërisht nga detyrimet e konfidencialitetit, që kanë interes të ligjshëm për marrjen e këtij informacioni, informacion mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje Huaje dhe Projektit. KfW-ja, lëshuesi i garancisë federale dhe Republika Federale e Gjermanisë kanë të drejtë të transmetojnë informacion në lidhje me Huan dhe Projektin, duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga Huaja për organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me aspektet për shërbimin e borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave mbi dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga Huaja. E drejta e mësipërme për dhënien e informacionit organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për t'ia transmetuar drejtpërdrejt këtë informacion anëtarëve të këtyre organizatave.

13.11 Hyrja në fuqi dhe efekt. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi dhe efekt derisa Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën bazohet, të ketë hyrë në fuqi dhe efekt dhe derisa Huamarrësi të ketë informuar KfW-në, me



shkrim, se Marrëveshja e Projektit dhe e Huas është ratifikuar dhe ratifikimi i saj është publikuar sipas rregullave.

Bërë në ___ kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, Tiranë, në datën _____
në datën _____

KfW Këshilli i Ministrave i
Republikës së Shqipërisë, i
përfaqësuar nga
Ministria e Financave
Fondi Shqiptar për
Zhvillim

ANEKSI 1 GRAFIKU I DISBURSIMIT

Grafiku më i shpejtë i mundshëm i disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (Data e Hyrjes në Fuqi të Përfundimit të Periudhës, në përputhje me listën e mëposhtme), Huamarrësi mund të kërkojë disbursime deri në një masë që nuk tejkalon shumën kumulative të disbursimeve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme.

Periudha	Data e hyrjes në fuqi të përfundimit të periudhës	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në EURO)
1	30.12.2015	2.400.000,00
2	30.6.2016	8.400.000,00
3	30.12.2016	14.400.000,00
4	30.6.2017	20.400.000,00
5	30.12.2017	24.000.000,00

ANEKSI 2

Model i Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor për Huamarrësin (Shteti)

Shënim. Ju lutem ndryshoni siç duhet "Republika e VENDIT"/"VENDI".

[Koka e letrës së Këshilltarit Ligjor]

KfW _____
(datë)

Departamenti [_____]
Në vëmendje të: [_____]

Palmengartenstrasse 5–9
Postfach 11 11 41
60325 Frankfurt am Main / Germany

Republika Federale Gjermane

